



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 10 nëntor 2014**

**Numri i lëndës: 2014-23**

**Shaip Selmani**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 27 mars 2014.

## **II. FAKTET**

2. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliohen si në vijim.
3. Me 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut e Prishtinës në përbërje të trupit gjykues të përzier me gjykatës të EULEX-it ka gjetur ankuesin fajtor për pjesëmarrje në një grup të krimit të organizuar në përputhje me nenin 274 par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe e ka dënuar atë me tetë vite burgim. Ankuesi ishte liruar nga akuzat për kontrabandim të emigrantëve në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 138 par. 6 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së.
4. Prokurori publik nuk ishte ankuar kundër këtij aktgjykimi.
5. Në një datë të pasaktësuar, ankuesi është ankuar kundër këtij aktgjykimi.
6. Më 2 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në përbërje të një trupi gjykues të përzier me gjykatës të EULEX-it, ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës duke gjetur ankuesin “fajtor për kryerjen e veprës të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 par. 4 në lidhje me veprën e kontrabandimit të emigrantëve në kundërshtim me nenin 138 par. 6 të lexuar me par. 1 të KPPK-së”.
7. Në një datë të pasaktësuar, ankuesi ka parashtruar një kërkesë në Gjykatën Supreme për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik. Ai ende nuk ka marrë ndonjë vendim në lidhje me këtë kërkesë.

## **III. ANKESAT**

8. Në thelb, ankuesi kërkon nga Paneli të përcaktoj nëse ka shkelje përkatëse të të drejtave të njeriut dhe të lirohet ankuesi nga burgu.

## **IV. LIGJI**

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
11. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
12. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim Paneli nuk ka juridiksion mbi aspektet administrative e as juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të DhVGjS-së, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih, ndër të tjera, *Krapi kundër EULEX-it*, 2014-22, 26 gusht 2014, në par. 12; *V. kundër EULEX-it*, 2013-23, 26 maj 2014, par 10; *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, në par 25; *Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, par 21; *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012, par. 9-10; *Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03, 4 tetor 2012, par 12; *Zeka kundër EULEX-it*, 2012-02, 4 tetor 2012, par. 21). Si rezultat, në parim Paneli nuk është i autorizuar të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, sikurse në rastin e kësaj ankese.
13. Si rezultat kjo ankesë nuk bie brenda kuadrit të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

## **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese